




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



## **RAPORT GJASHTËMUJOR I KOMITETIT PËR KOMUNITETE JANAR-QERSHOR 2017**

### **1. Gjendja e sigurisë**

Gjendja e përgjithshme e sigurisë gjatë periudhës Janar -Qershor 2017 ka qenë e mirë dhe stabile. Sipas raportimeve të përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë dhe Policisë së Kosovës, nuk është regjistruar asnjë eksces ndëretnik në territorin e Komunës së Prishtinës.

### **2. Qasja e komuniteteve jo shumicë në shërbimet publike**

Komunitetet jo shumicë kanë pasur qasje të mira në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Komiteti për Komunitete, drejtoritë komunale me shërbimet e tyre, u kanë kushtuar mjaft kujdes anëtarëve të komuniteteve, atyre që kanë kërkuar të pajisen me dokumentacion personal, familjar dhe pronësor.

### **3. Takimet e Komitetit për Komunitete**

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2017 Komiteti për Komunitete ka mbajtur 7 takime, në të cilat takime janë shqyrtuar këto çështje:

- Hartimi i Planit të punës së Komitetit për vitin 2017,
- Bashkëpunimi me drejtoritë dhe institucionet e tjera të Komunës: Kryetarin, Nënkryetarin, Drejtorin e Administratës, Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, zyrtarët e OSCE-së, MKK, Policinë e Kosovës, KFOR-in, zyrtarë të organizatave jo qeveritare dhe ndërkombëtare,
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të anëtarëve të komuniteteve mbi gjendjen e tyre ekonomike-sociale, të sigurisë, dhe objektivat e përbashkëta të kthimit dhe ri integritimit,

- Vlerësimi i vizitave të kryera në rajonet me anëtarë të komuniteteve, institucioneve komunale-shkollave në mjediset ndëretnike, familjeve, organizatave shoqërore dhe aktiviteteve të tjera në bazë të Planit të punës të Komitetit për Komunitete në vitin 2017, Gjithashtu në takim u diskutua edhe për Programin Mbështetës të Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Zonat Rurale nga Konzorciumi Dorch/CDI i bashkëfinancuar nga Qeveria Zvicërrane dhe e Kosovës, që është kërkuar të kryej një vlerësim nëpër të gjitha komunat për të mbledhur informata rreth qasjes së ekonomive familjare të komunitetit RAE në sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Ka shqyrtuar evidencën e Familjeve të cënueshme të komuniteteve për ndihmë duke i njoftuar drejtoritë kompetente dhe zyrtarët komunal,
- Komiteti gjatë seancave ka nxjerrë shumë konkluzione, të cilat ia ka drejtuar drejtorive përkatëse për t'i implementuar ato,
- Ka shqyrtuar dhe vlerësuar projekte të ndryshme për zhvillimin e komuniteteve jo shumicë të përgatitura nga ZKKK,
- Ka ftuar anëtarë dhe kryesues të disa komiteteve të disa komunave për një shkëmbim përvojash si dhe njoftimi i tyre me punën dhe angazhimin e anëtarëve të komitetit për komunitete të komunës së Prishtinës,
- Ka përcjell dhe përkrahur projektet e IOM-it për ndarjen e mjeteve përfituesve si dhe Shqyrtimin e e kërkesave të anëtarëve të komuniteteve Ashkali dhe Serb.

**Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar dhe miratuar propozim-projektet e komuniteteve jo shumicë për vitin 2017, si vijon;**

1. Rregullimi i objektit (i ashtuquajtur objekt i veterinës) në Bardhosh dhe transformimin e këtij objekti në shtëpi kulture dhe biblioteke në Bardhosh,
2. Ndërtimi i fushës së futbollit të vogël dhe basketbollit në fshatin Bërnice e Poshtme,
3. Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore në Bërnice të Poshtme në njërin krah me gjatësi prej 2.5 km,
4. Asfaltimi i rrugëve dytësore në Bërnice të Poshtme me gjatësi prej 1.5 km,
5. Asfaltimi i rrugës prej kanalit të Ibër-Lepencit deri tek varrezat në Bardhosh,
6. Rregullimi i një toaleti në oborrin e kishës "Sveti Nikola" në Prishtinë.

#### 4. Takimet e zyrtarëve të Zyrës për Komunitete

- Katër takime me pjesëtarët e KFOR-it kishin për qëllim realizimin e bashkëpunimit korrekt dhe njoftimin e ndërsjellë përkitazi me projektet e vitit 2017, vazhdimin e bashkëpunimit si dhe adresimeve të përbashkëta gjatë këtij viti. Zyra ka kontaktuar dhe bashkëpunuar me Drejtorinë e Arsimit dhe drejtoritë tjera te Komunës,
- Takimi me përfaqësuesin e komunitetit ashkali, rreth mundësisë për realizimin e projekteve të vitit 2016/2017, si komunitet jo shumicë,
- Takimi me zyrtarë nga OSBE, lidhur me çështjet e ri integritit dhe për çështje të tjera në kuadrin e respektimit të drejtave të komuniteteve jo shumicë,
- Takimi me përfaqësuesin e komunitetit rom, për t'i diskutuar projektet që mund të procedoheshin, si dhe data të tjera të rëndësishme për komunitetin rom;
- Takim me drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, me qëllim të koordinimit të punëve dhe aktiviteteve që ndërliidhen me komunitetet jo shumicë,
- Përgatitja e fushatës mbi regjistrimin civil falas të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e planifikuar në periudhën 15.06.2017 deri 31.07.2017. Njoftimet e shtypura u janë dorëzuar dhe shpërndarë në lagjet e tyre përmes njoftimit përkatës,
- Takimi me drejtorine Drejtoris te Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me organizimin e ditës së Flamurit Ashkali, propozimet përkatëse dhe mundësitë financiare,
- Organizimi i takimit me drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Në pika të përgjithshme u diskutuan mundësitë materiale për përfitim të ndihmave për komunitete,
- Takimi i grupit punues nga KK dhe një anëtarë nga ZKKK Prishtinë, për takim në MK, temë diskutimi ishte koordinimi më i mirë me MKK-në në lidhje me kthimin dhe ndihmën komuniteteve në territorin Komunës së Prishtinës. Duke pasur parasysh se në drejtimin e kthimit (ndërtimit të shtëpive) në Komunën e Prishtinës është bërë shumë pak, ishte e nevojshme që MKK-ja, për vitin 2017, t'i japin prioritet vlerësimit të objekteve me urgjencë, ndërtimit të shtëpive për të kthyerit. Të gjithë individët mund t'i dorëzojnë kërkesë për ndihmë përmes arkivit të MKK-së personalisht,
- Takim me zyrtarët e Qendrës kulturore për pjesëmarrjen e fëmijëve të Komuniteteve në audicion,
- Me inicimin e Komitetit dhe ZKKK, Administrata komunale e përkrahi festimin e festës së komunitetit boshnjak, duke subvencionuar me material sanitar dhe shkollor,
- Takim me drejtorin e Administratës z. Muhedin Nushi, lidhur me projektet e mundshme për procedim për komunitetet jo shumicë,
- Takim me drejtorin e Drejtorisë së Kulturës për implementimin e projektit për nder të 8 Prillit, Ditës ndërkombëtare të romëve,
- Tryeza e rrumbullakët e organizuar nga VORAE për implementimin e projektit trevjeçar – përfshirja sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për romët, ashkalitë dhe egjiptianët si dhe integrimi i komuniteteve në shoqërinë kosovare, planet e kësaj organizate gjatë vitit 2017 për komunitetet RAE dhe bashkëpunimin e

vazhdueshëm që do ta kemi në implementimin e projekteve të ndryshme të përgatitura nga organizata përkatëse,

-Takim pune me z. Idriz Berisha lidhur me çështje të ndryshme të komunitetit ashkali, festimin e Ditës së Flamurit Ashkali dhe kërkesë-përkrahjen e dorëzuar në Drejtorinë e Kulturës,

-Takim pune me sekretarin e Kryqit të Kuq në Prishtinë z. Hasan Mustafa. Në takim është diskutuar për projektin e ZKKK-së për mirëqenien e nxënësve të komuniteteve RAE, që si qëllim kryesor ka ndihmesën në veshmbathje të anëtarëve të komuniteteve RAE,

-Takime pune në Qendrën për Punë Sociale,

-Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar takim pune me përfaqësuesen e organizatës joqeveritare „VoRAE“ lidhur me hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Komunës së Prishtinës dhe organizatës joqeveritare „VoRAE“. Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshjeje do të jetë përfshirja sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, si dhe grupe tjera të cënueshme. U konstatua se gjatë muajit Maj do të arrihet hartimi dhe procedimi i kësaj marrëveshjeje,

-Është mbajtur takimi i Nëngrupit Punues Komunal për Kthim për procedimin e gjashtë (6) rasteve të familjeve të zhvendosura Serbe për verifikim të posedimit të pronës në Drejtorinë e Kadastrit“ në Komunen e Prishtinës,

-Është mbajtur takimi i Grupit Punues për shtresat e marginalizuara lidhur me zhvillimin e aktiviteteve vetëdijuese për migrimin e paligjshëm. U konstatua se aktivitetet e tilla janë në funksion të parandalimit të migrimit,

-ZKKK mori pjesë në seminarin e organizuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Taix lidhur me legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. U shqyrtuan raste dhe modele të ndryshme të funksionimit të praktikave më të mira të zbatimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë,

-Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar takim pune me znj. Igballe Ymeri nga IOM. Në takim është diskutuar për përfituesit nga Komuna e Prishtinës, si vijon: 1. Jakup Berisha (i komunitetit ashkali) ka përfituar mjete pune për artin e tij me penjë; 2. Srboljub Pavic (i komunitetit serb) ka përfituar dy krerë lopë; U potencua se përfituesit pas tre muajve të fillimit të punës janë të obliguar që 5% e grantit të fituar t'i jepet ndonjë familjeje që është në kushte të rënda ekonomike,

-Zyrtarët e ZKKK morën pjesë në takimin e Grupit punues për të drejtat sociale për grupet e marginalizuara në Komunën e Prishtinës, takim i organizuar nga GIZ. Pikë kryesore e rendit të ditës ishte draftimi i planit lokal të veprimit për vitin 2017, për identifikimin e projekteve kyçe në riintegrimin e personave të riatdhesuar, projekte të mbështetura nga GIZ,

-Zyrtarët e ZKKK kanë zhvillua 5 takime pune me z. Selami Maliqi nga organizata joqeveritare “Advancing Together” lidhur me draftimin e planit lokal të veprimit për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme. Takimi u fokusua rreth organizimit të mbajtjes së takimit të parë të Grupit punues për hartimin e këtij planveprimi,

- Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar takim pune me përfaqësuesen e organizatës joqeveritare VoRAE znj. Kadrije Krasniqi dhe përfaqësuesen e organizatës “Terres des Hommes” znj. Ilirjana Vorfaj. U propozuan projektet e OJQ-ve dhe ZKK-së për vitin 2017 dhe koordinimit të ndërsjellë për realizimin e tyre. Projektet që u potencuan nga VoRAE për vitin 2017 janë projekte që përfshijnë fushën sociale, si: planet aksionale në nivel lokal, involvimi në debate me anëtarët e komuniteteve joshumicë, organizimi i takimeve me anëtarë të komuniteteve joshumicë, programi për të drejtat e njeriut, përfshirja në fushën e edukimit, në fushën e ekonomisë, etj.
- Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar takim pune me znj. Sanela Sadikoviç – koordinatorë për projekte dhe grante pranë Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit. Kjo Zyre për vitin 2017 ka në plan projektet, si në vijim: a) programin për ndarjen e subvencioneve në dy thirrje aplikuese – ojç dhe medie; b) ndërtimin e shtëpive; c) mbështetjen e manifestimeve të festave kombëtare të komuniteteve joshumicë; d) mbështetjen e komuniteteve me material higjienik; e) programin e praktikës për studentë të komuniteteve – rreth 100 studentë;
- Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar vizitë nxënësve të komuniteteve rom, ashkalij dhe egjiptas në dy shkollat fillore që janë të frekuentuara më shumë me nxënës të këtyre komuniteteve SHFMU “Asim Vokshi” dhe SHFMU ‘Emin Duraku”,
- Takimi në SHFMU “Asim Vokshi” u mbajt me drejtoreshën e shkollës znj. Silvana Beqaj, e cila konstatoi se në këtë shkollë vijojnë mësimin 34 nxënës të komuniteteve RAE, prej të cilëve 18 femra dhe 16 meshkuj. Sipas vizitës që u zhvillua, nuk vërehej segregacion apo ndarje në mes të nxënësve. Lidhur me braktisjen e procesit mësimor nga nxënësit e këtyre komuniteteve, znj. Beqaj përmendi vetëm një rast, por që ekipi për parandalimin e braktisjes së shkollës është marrë në vazhdimësi me këtë rast dhe është munduar që ky nxënës të vijoi procesin mësimor,
- Takimi në SHFMU “Emin Duraku” u mbajt me drejtorin e shkollës z.Agron Mexhuani, i cili konstatoi se në këtë shkollë vijojnë mësimin 25 nxënës të komuniteteve RAE. Sipas vizitës që u zhvillua, nuk vërehej segregacion apo ndarje në mes të nxënësve. Lidhur me braktisjen e procesit mësimor nga nxënësit e këtyre komuniteteve, z. Mexhuani përmendi dy raste të cilat kanë braktisur procesin mësimor dhe që ekipi parandalues për braktisjen e shkollës është duke u munduar që këto raste të vijojnë procesin mësimor,
- ZKKK ka proceduar dy projektet vjetore subvencionuese për nxënësit e komuniteteve RAE, projekt ky i cili ka qëllim shperndarjen e artikujve higjienike/sanitare dhe artikuj shkollor. Projekti është miratuar nga Drejtori i Administratës z.Muhedin Nushi për të vazhduar me procedurat e mëtutjeshme. Projekti është në fazën e zbatimit dhe do të njoftohen shkollat, me rastin e implementimit të këtij projekti,
- Është mbajtur takimi i parë i Grupit Punues për hartimin e planit lokal të veprimit për kthimin e të zhvendosurve dhe zgjidhje të qëndrueshme. Ky grup është formuar me vendim të Kryetarit të Komunës dhe ka për detyrë të hartoi planin lokal të veprimit, duke u bazuar në rregullativën ligjore për kthimin e të zhvendosurve. Ky takim ishte më tepër takim i karakterit informues,

-Zyrtarët e ZKKK kanë zhvilluar vizitë në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Tophane, për tu njoftuar më hollësisht lidhur me shërbimet shëndetësore që ofron kjo qendër, duke ditur se është qendra më e afërt e komuniteteve RAE. Takimi u zhvillua me shefin e QMF-së z. Abdullah Simnica, i cili na njoftoi se në këtë qendër ofrohen shërbimet shëndetësore, si: vizitat e zakonshme mjekësore, vaksionimi, dhënia e infuzionit, shërbimet pediatrike, stomatologjike, laboratorit si dhe shërbimet e dermatologjisë. Sipas Shefit të QFM-së, shumica e pacientëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas që vizitohen në këtë ambulantë marrin asistencë sociale dhe prandaj janë të liruar nga pagesat për shërbime shëndetësore që u ofrohen. Të liruar nga pagesat gjithashtu janë: grate shtatzëna, studentët, veteranët e luftës, penzionistet, fëmijët etj. Sipas motrave dhe mjekëve në këtë ambulantë, gratë shtatzëna të komunitetit rom, ashkalij dhe egjiptas vizitohen vazhdimisht për analiza dhe kontrolla të zakonshme, ndërsa për kontrolla gjinekologjike udhëzohen në Shtëpinë e Shëndetit. Me vizitën e tillë, kemi hasur në rritje të vedijësimit të komunitetit rom, ashkalij dhe egjiptas për kujdesin shëndetësor ndaj familjarëve të tyre, e posa qërisht ndaj gruas shtatzënë.

## **5. Vizitat e Komitetit për Komunitete**

Gjatë perjudhes Janar-Qershor 2017 Komiteti për Komunitete përmes komisioneve dhe grupeve punuese ka vizituar, si në vijim:

- Komunitetin Ashkali, në "Kodrën e Trimave",
- Shkollën fillore multietnike "Asim Vokshi" Prishtinë,
- Shkollën fillore multietnike "Emin Duraku" Prishtinë,
- Gjimnazin "Sami Frashëri" - nxënësit e komunitetit turk,
- Shkollën e mesme "Ali Sokoli" - nxënësit e komunitetit boshnjak,
- Nxënësit e komunitetit turk, rom dhe boshnjak në Prishtinë.
- Ka ndarë mjete higjienike dhe shkollore për 9 SHFMU dhe gjashtë shkolla SHML ku mësimet i ndjekin 104 nxënësit e komuniteteve,
- Ka vizituar çdo muaj Qendrën për Paqe dhe Tolerancë, me qëllim të informimit të drejtpërdrejtë për problemet eventuale dhe të informimit të komunitetit serb, si dhe vizitat në kishën "Sveti Nikolla" në Prishtinë,
- Ka vizituar Familjen Dërmonçiq, e cila është në një gjendje të rëndë, sepse janë të sëmurë anëtarët e familjes. U vizitua edhe Lepasava Stojanoviç në barakë afër RTK. Ka vizituar Familjen Mazade Balkon e komunitetit turk.

## **6. Kërkesat**

Gjatë vitit 2016 Komiteti për Komunitete ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e anëtarëve të komuniteteve: për ndihmë emergjente, strehim, riparime dhe për kompensim dëmi. Këto kërkesa janë proceduar në drejtoritë përkatëse për realizimin e tyre. Shumica prej tyre janë realizuar.

## **7. Ndhurma familjeve dhe nxënësve të komuniteteve**

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka iniciuar projektin për përkrahje me pako higjienike dhe sanitare për 120 familje të komuniteteve joshumicë. Pas përfundimit të të gjitha procedurave tenderuese dhe procedurave tjera, projekti është implementuar më 11.01.2017 dhe janë shpërndarë 90 pako higjienike sanitare, si vijon: 78 pako për komunitetin ashkali, 5 pako për komunitetin rom, 3 pako për komunitetin turk, 2 pako për komunitetin boshnjak dhe 2 pako për komunitetin shqiptar.

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka implementuar projektin për shpërndarje të pakove higjienike sanitare dhe pakove shkollore për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Në shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm në Komunën e Prishtinës, vijojnë mësimin rreth 110 nxënës të komunitetit rom, ashkalij dhe egjiptas. Shpërndarja e pakove higjienike sanitare dhe pakove shkollore për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas është zhvilluar, si në vijim:

- SHFMU “Asim Vokshi” janë shpërndarë 37 pako higjienike sanitare dhe 37 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Shkolla Model” janë shpërndarë 3 pako higjienike sanitare dhe 3 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Emin Duraku” janë shpërndarë 34 pako higjienike sanitare dhe 34 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Naim Frashëri” janë shpërndarë 5 pako higjienike sanitare dhe 5 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Gjergj Fishta” janë shpërndarë 11 pako higjienike sanitare dhe 11 pako me artikuj shkollor,
- SHML “Shtjefën Gjeçovi” janë shpërndarë 10 pako higjienike sanitare dhe 10 pako me artikuj shkollor,
- SHML “Hoxhë Kadri Prishtina” janë shpërndarë 10 pako higjienike sanitare dhe 10 pako me artikuj shkollor.

Zyrtarët e ZKKK-së me përkrahjen e Komitetit dhe drejtorit të Administratës bënë ndarjen e mjeteve higjienike dhe mjeteve mësimore për nxënësit e komunitetit rom dhe ashkali. Komisioni i ZKK ka ndarë mjete higjienikë dhe shkollore në nëntë SHFMU dhe gjashtë SHML ku mësimet i ndjekin 104 nxënësit të komuniteteve të financuara nga Komuna e Prishtinës.

Me iniciativën e ZKKK-së dhe përkrahjen e Komitetit, familjet skamnore të komunitetit RAE, serbë dhe boshnjakë janë furnizuar me nga 2 m<sup>2</sup> dru zjarri dhe kanë marrë nga 100 € ndihma emergjente nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Komisioni për identifikimin e familjeve të cenueshme nga radhët e komuniteteve joshumicë, i formuar nga Komitetit për Komunitete, ka zhvilluar vizitë në familjet e komuniteteve joshumicë që janë konsideruar si familje të cënueshme. Komisioni ka hartuar një raport në detaje për secilën familje që është shqyrtuar dhe miratuar në Komitetin për Komunitete.

Zyra për Komunitete dhe Kthim ka implementuar projektin për shpërndarje të pakove higjienike sanitare dhe pakove shkollore për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Në shkollat e nivelit fillor dhe të mesëm në Komunën e Prishtinës, vijojnë mësimin rreth 110 nxënës të komunitetit rom, ashkalij dhe egjiptas. Shpërndarja e pakove higjienike sanitare dhe pakove shkollore për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas është zhvilluar, si në vijim:

- SHFMU “Asim Vokshi” janë shpërndarë 37 pako higjienike sanitare dhe 37 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Shkolla Model” janë shpërndarë 3 pako higjienike sanitare dhe 3 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Emin Duraku” janë shpërndarë 34 pako higjienike sanitare dhe 34 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Naim Frashëri” janë shpërndarë 5 pako higjienike sanitare dhe 5 pako me artikuj shkollor,
- SHFMU “Gjergj Fishta” janë shpërndarë 11 pako higjienike sanitare dhe 11 pako me artikuj shkollor,
- SHML “Shtjefën Gjeçovi” janë shpërndarë 10 pako higjienike sanitare dhe 10 pako me artikuj shkollor,
- SHML “Hoxhë Kadri Prishtina” janë shpërndarë 10 pako higjienike sanitare dhe 10 pako me artikuj shkollor.

## **8. Projektet për zhvillim të komuniteteve joshumicë në Komunën e Prishtinës**

1. Rregullimi i objektit (i ashtuquajtur objekt i veterinës) në Bardhosh dhe transformimin e këtij objekti në shtëpi kulture dhe biblioteke në Bardhosh,
2. Ndërtimi i fushës së futbollit të vogël dhe basketbollit në fshatin Bërnice e Poshtme,



3. Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore në Bërnice të Poshtme në njërin krah me gjatësi prej 2.5 km,
4. Asfaltimi i rrugëve dytësore në Bërnice të Poshtme me gjatësi prej 1.5 km,
5. Asfaltimi i rrugës prej kanalit të Ibër-Lepencit deri tek varrezat në Bardhosh,
6. Rregullimi i një toaleti në oborrin e kishës "Sveti Nikola" në Prishtinë.

Në konkursin për aplikim të projekteve për grante-subvencionim të shpallur nga IOM prej 01.02.2016 - 19.02.2016 kanë aplikuar 12 anëtarë të komuniteteve joshumicë ( 9 anëtarë të komunitetit serb; 2 anëtarë të komuniteteve RAE; dhe 1 anëtar i komunitetit goran).

## 9. Konkluzionet

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2017, Komiteti për Komunitete nga takimet e mbajtura ka nxjerrë 33 konkluzione, shumica prej të cilave janë implementuar.

## 10. Sfidat

Gjatë periudhës Janar -Qershor 2017, Komiteti për Komunitete ka hasur edhe në sfida dhe vështirësi për kryerjen e punëve. Sfidat kryesore janë:

1. **Drejtoria e Pronës** nuk e ka zbatuar konkluzionin e Komitetit dhe as nuk e ka inicuar tek organet kompetente problemin për identifikimin, uzurpimin dhe lirim të banesës në ndërtesën banesore në YU Program në lagjen "Ulpianë", si dhe në objektin banesor në rrugën "Ragip Loxha" afër "Shtëpisë së Pleqëve",
2. **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** nuk i ka zbatuar konkluzionet e Komitetit për Komunitete për ndihmë në strehimin e përkohshëm dhe ndihmë materiale për anëtarin e komunitetit boshnjak, Sakiba Jashari dhe anëtarin e komunitetit rom Adnan Ajeti, pasi pozita e tyre ekonomike dhe sociale është shumë e vështirë,

3. Komiteti për Komunitete nga ana e **Zyrës Ligjore** nuk është informuar fare me rregulloret, vendimet, konkurset e shpallura dhe aktet e tjera juridike, edhe pse janë zotuar nga menaxheri i personelit,
4. Mund të konstatohet se Komiteti për Komunitete i ka shqyrtuar dhe realizuar të gjitha aktivitetet që janë planifikuar sipas Planit të punës 2017 dhe Rregullores së punës të Komitetit për Komunitete,
5. **Drejtoria e Kulturës** edhe pas disa kërkesave nga ZKKK nuk e ka informuar Komitetin për Komunitete për projektet subvencionuese dhe përfituesit nga radha e komuniteteve jo shumicë.
6. Nuk është bërë ndarja e kontinjerëve të mbeturinave në Bërnice të Poshtme dhe Rr. “Bedri Gjini”, ashtu siç është paraparë.

**Komiteti për Komunitete**

**Sylejman Pireva**